



Kolegji ESLG

Vendim Nr. Prot. 1215
29 / 07 / 2021

Në bazë të dispozitave të nenit 30 paragrafi 2, si dhe neni 56 të Statutit të Kolegjit ESLG, në përputhje me nenin 7 dhe 8 të Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 13/2018 për Sistemin e Menaxhimit të Informatave në Arsimin e Lartë, dhe në harmoni me nenin 13, paragrafin 2, pikën 3, neni 29, paragrafit 7, neni 30, paragrafit 5 të Ligjit Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, bazuar në Vendimet për akreditimin e programeve të studimeve dhe licencimin e tyre, për regjistrimin e studentëve për vitin e ri akademik 2021/2022, Rektori i Kolegjit ESLG-së miratoi këtë:

V E N D I M

Shpallet konkursi i rregullt publik për pranimin dhe regjistrimin e studentëve të rinj, për vitin e ri akademik 2021/2022, në programet e studimit të akredituara nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) dhe licencuara nga MASHT, sipas drejtimeve në vijim:

- Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (BA) – 80 vende të studimit;
- Menaxhimi i Patundshmërive dhe Infrastrukturës (MA) – 80 vende të studimit;

Shpallja e konkursit për regjistrimin e studentëve të rinj, bëhet në mjetet e përditshme të informimit publik.

Të drejtën e konkurrimit dhe të regjistrimit në studimet themelore (Baçelor) e kanë të gjithë kandidatët të cilët e kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë të nivelit 3 sipas ISCED dhe të cilët e kanë përfunduar me sukses testin kombëtar të maturës.

Në rast se ka më shumë aplikantë se që është numri i vendeve të studimit atëherë të drejtën e pranimit në programin baçelor e kanë të gjithë studentët që plotësojnë kriteret si në vijim:

- Shkollimi i mesëm i përfunduar me notë mesatare së paku 3.5;
- Kryerja me sukses e provimit të maturës;



Kolegji ESLG

Gjatë marrjes së vendimit, Komisioni për çështje të pranimit të studentëve i jep peshën si në vijim kritereve të mëposhtme:

- Nota mesatare - 70 %;
- Rezultatet e testit të maturës - 30 %;

Për regjistrimin në studimet Master, kërkohet që kandidati të ketë përfunduar studimet Baçelor.

Në rast se ka më shumë aplikantë se që është numri i vendeve të studimit atëherë të drejtën e pranimit në programin master e kanë të gjithë studentët që plotësojnë kriteret si në vijim:

- Nota mesatare gjatë studimeve baçelor e barabartë ose më e lartë se 7.5;
- Nëse kandidati posedon përvojë të punës prej më shumë se 3 vjet në fushën e kompetencave të programit, atëherë kriteri i notës mesatare do të revokohet.

Studentët mund të aplikojnë online përmes faqes së internetit:

<http://www.eukos.org/?page=1,108> ose në mënyre fizike në ambientet e Kolegjit ESLG.

Studentët të cilët aplikojnë në studime themelore, i bashkangjesin aplikacionit dokumentet si në vijim:

1. Çertifikatën e maturës shtetërore - origjinal ose kopje e notarizuar;
2. Diplomën e shkollës së mesme - origjinal ose kopje e notarizuar;
3. Dëftesat e shkollës së mesme - origjinal ose kopje e notarizuar;
4. Ekstraktin e lindjes dhe
5. Dy fotografi të pasaportës;

Studentët të cilët aplikojnë në programin master, i bashkangjesin aplikacionit dokumentet si në vijim:

1. Diplomën e studimeve themelore - origjinal ose kopje e notarizuar;
2. Çertifikatën e notave - origjinal ose kopje e notarizuar;
3. CV-në profesionale
4. Ekstraktin e lindjes dhe
5. Dy fotografi të pasaportës;



Kolegji ESLG

Regjistrimi i studentëve realizohet për nivelin baçelor nga data 29.07.2021 deri me datën 05.10.2021, ndërsa në nivelin master nga data 01.08.2021 deri me datën 10.11.2021.

Regjistrimi i studenteve të transferuar nga një institucion tjetër në Kolegjin ESLG mund të realizohet nga 25.09.2021 deri me 30.09.2021 për semestrin dimëror, ndërsa transferet për semestrin veror të të njëjtit vit akademik mund të realizohen nga data 23.02.2022 deri me 28.02.2022.

Studentet dorëzimin e aplikacioneve e realizojën prej momentit të publikimit të këtij vendimi, ndërsa kontrata për studime zyrtarizohet pas vendimit për pranim në përputhje me datat e theksuara më lartë.

Cilësia e pranimit të studentëve duhet të realizohet nëpërmjet suksesit më të mirë nga shkollimi i mesëm dhe studimet themelore, ashtu siç është përcaktuar në konkurs në rast se ka më pak aplikantë se vende të studimit, përndryshe aplikohen kriteret e cekura më lartë.

Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset shërbimi përkatës i Kolegjit ESLG.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Rektori i Kolegjit ESLG

Prof. Dr. Visar Hoxha

